REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Nr.6027/1 prot. Tiranë, më 9.11.2026

Lënda: Shpallje për subjektin "NASUFI" SH.P.K

SUBJEKTIT "NASUFI" SH.P.K ME NIPT M41915011U
Adresë: Rr. "Sokrat Miho", Vila L2, Kati 1, 1052, Tiranë

TIRANË

Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Tiranë, ka kryer inspektim në subjektin "NASUFI" sh.p.k me Nipt M41915011U dhe adresë Rr. "Sokrat Miho", Vila L2, Kati 1, 1052, Tiranë. Në përfundim të procesit të inspektimit në mbështetje të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 "Për inspektimin e Punës", i ndryshuar, është ndërmarrë vendimi përfundimtar i inspektimit me Nr.ISHPSHSH-TR-2026-004537-5, datë 12.10.2026,ku ndaj subjektit është vendosur masë administrative kryesore "Paralajmërim". Në zbatim të procedurave që parashikon ligji nr.99, datë 12.09.2024 "Për Inspekimin në Republikën e Shqiperisë", njoftimi i subjektit për këtë vendim përfundimtar nuk është bërë i mundur të kryhet nëpërmjet dorëzimit personal dhe me postë në adresën ku subjekti ushtron aktivitet, adresa e deklaruar në ekstraktin e QKB-së. Objekti postar është kthyer mbrapsht me shënimin "Objekt i pa kërkuar".
Bazuar në nenin 162 të ligjit nr. 44/2015 Kodi Procedurës Administrative, Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH-së Tiranë ka vendosur, njoftimin e subjektit "NASUFI" sh.p.k me Nipt M41915011U dhe adresë Rr. "Sokrat Miho", Vila L2, Kati 1, 1052, Tiranë, për njohjen me këtë vendim përfundimtar të inspektimit me anë të shpalljes dhe njoftimit duke e afishuar në zyrat e ISHPSHSH-së, në adresën e subjektit ku është ushtruar inspektim, QKB dhe në faqen zyrtare të web.
Në zbatim të pikës 3 të nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 Kodit të Procedurës Administative njoftimi do të vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.
Kundër Vendimit Përfundimtar të Inspektimit subjekti "NASUFI" sh.p.k, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.Ankimi paraqitet pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit të Inspektoratit të Përgjithshëm sipas ligiit nr.99, datë 12.09.2024 "Për Inspekimin në Republikën e Shqiperisë".
Për njohjen me përmbajtjen e plotë të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit dhe marrjen e kopjes së tij mund të paraqiteni pranë Drejtorisë Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë, adresë Rr. "Sheh Ahmet Pazari", nr.10, Tiranë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYEINSPEKTORI RAJONAL
Ardit Shabanaj

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
PËRGJEGJËS SEKTORI
ARMANDO LOGA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · DREJTORIA RAJONALE INSPEKTORATI SHTETËROR PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE · RAJONI 1 TIRANË

Skanuar me CamScanner